

## REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE 2021

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	5.1.2021	<p>A ka nisur procesi i matrikullimit, vaksinimit dhe shërbimit veterinar falas në të gjithë vendin? Në çfarë date ka nisur?</p> <p>Sa është numri i blegtorëve që përfitojnë nga ky proces?</p> <p>Cilat janë kriteret që blegtorët të përfitojnë nga ky shërbim?</p>	15.1.2021	<p>Procesi i shërbimit veterinar falas në të gjithë vendin për vaksinimin ka filluar në prill 2020, ndërsa për matrikullimin ka filluar më 23.11.2020.</p> <p>Nga shërbimi veterinar i matrikullimit dhe vaksinimit kanë përfituar 160 310 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë e treqind e dhjetë) fermerë.</p> <p>Për të përfituar nga shërbimi i matrikullimit të kafshëve, fermerët duhet të kenë regjistruar në sistemin RUDA fermën e tyre dhe të paraqesin një kërkesë pranë zyrave të shërbimit veterinar rajonal. Ndërsa, shërbimin e vaksinimit të kafshëve nga zyrat e shërbimit veterinar rajonal, e përfitojnë të gjithë fermerët që kanë regjistruar në sistemin RUDA fermën e tyre kur është planifikuar në programet e kontrollit të sëmundjeve.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

2	5.1.2021	<p>Kopje e propozimit të X Y si përfaqësues i Shqipërisë për bujqësinë në institucionet e Bashkimit Evropian.</p> <p>Emrat e punonjësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe funksionet përkatëse.</p> <p>Informacion mbi tokat e dhëna me qira, emrat e subjekteve që i kanë marrë me qira, afatin dhe tarifën përkatëse.</p>	25.1.2021	<p>X Y nuk është nëpunës i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Në Sekretariatit e Përfaqësisë në Bruksel nuk është emëruar asnjë nëpunës.</p> <p>Emrat e nëpunësve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe funksionet përkatëse janë publikuar në faqen zyrtare të ministrisë, në linkun: <a href="https://bujqesia.gov.al/struktura-analitike-e-mbzh/">https://bujqesia.gov.al/struktura-analitike-e-mbzh/</a>.</p> <p>Bashkëlidhur informacioni mbi tokat e dhëna me qira. <a href="#">Tokat Bujqesore te Dhena me Qera</a></p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
3	8.1.2021	<p>A keni ofruar mbështetje financiare për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit kalendarik 2020?</p> <p>Nëse keni ofruar mbështetje financiare, cila ka qenë forma e mbështetjes (grant, kontrata shërbimi, prokurim publik/tenderim, etj.)?</p> <p>Sa organizata të shoqërisë civile kanë aplikuar për</p>	21.1.2021	Gjatë vitit kalendarik 2020 nuk është ofruar mbështetje financiare dhe jo-financiare për organizatat e shoqërisë civile.	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>mbështetje financiare gjatë vitit 2020? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.</p> <p>Sa është numri i organizatave që kanë përfituar nga kjo mbështetje? Specifiko sipas formës nëse ka patur më shumë se një formë.</p> <p>Cila ka qenë shuma e përfitimit për organizatë dhe në total? Specifiko sipas formës në qoftë se ka patur më shumë se një formë.</p> <p>A keni ofruar mbështetje jofinanciare për organizatat e shoqërisë civile gjatë vitit 2020? Cila është baza ligjore/rregullatore që rregullon këtë mbështetje?</p> <p>Nëse po, sa organizata kanë përfituar nga mbështetja jofinanciare e ofruar? Cili ka qenë lloji i mbështetjes jofinanciare të ofruar?</p>				
--	--	---	--	--	--	--

4	14.1.2021	Informacion mbi institucionin përgjegjës për administrimin e pronës shtetërore me numër pasurie	18.1.2021	Bazuar në nenin 5, pika 2, të Ligjit Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”,	Deleguar	0
		287, Zona Kadastrale Nr. 3544		Agjencia Shtetërore e Kadastrës është organi kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e proceseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.		

5	19.1.2021	<p>Sa është numri i çështjeve gjyqësore administrative për heqje nga puna të punonjësve të administratës me të paditur Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në harkun kohor 1 janar 2014 – 31 dhjetor 2020?</p> <p>Sa është numri i çështjeve gjyqësore administrative për heqje nga puna të punonjësve të administratës me të paditur Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në harkun kohor 1 janar 2014 – 31 dhjetor 2020, në të cilat Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me vendim gjykate është dashur të paguajë dëmshpërblim</p>	1.2.2021	<p>Në periudhën 1 janar 2014 – 31 dhjetor 2020 në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë larguar nga shërbimi civil 11 (njëmbëdhjetë) punonjës, të cilët e kanë bërë çështjen objekt konflikti gjyqësor.</p> <p>Në kuadër të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka dëmshpërblyer 2 (dy) gjyqfitues.</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka dëmshpërblyer gjyqfituesit në vlerën 9,786,580 lekë.</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
---	-----------	---	----------	--	-------------------------------	---

		<p>financiar kundrejt palës paditëse?</p> <p>Sa është vlera financiare totale e dëmshpërblimeve nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, caktuar me vendime gjyqësore, kundrejt paditësve në harkun kohor 1 janar 2014 – 31 dhjetor 2020 për shkak të heqjeve nga puna të punonjësve të administratës?</p> <p>Sa është vlera totale e detyrimeve të prapambetura që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka akumuluar në kuadër të dëmshpërblimeve për shkak të pushimit nga puna?</p>		detyrime të prapambetura ndaj gjyqfituesve.		
6	21.1.2021	<p>Në çfarë niveli është zbatuar marrëveshja CEFTA për tregtimin e lirë të mallrave në sektorin e vreshtarisë?</p> <p>Si po e ndihmon konkretisht vreshtarin shqiptar shteti</p>	27.1.2021	<p>Marrëveshja CEFTA zbatohet për të gjitha produktet bujqësore. Lidhur me sektorin e vreshtarisë nuk ka tarifa me vendet përkatëse.</p> <p>Në ndihmë të sektorit të vreshtarisë dhe verës, është</p>	Pyetja e katërt është deleguar. Për pyetjet e tjera përgjigja është dhënë e plotë.	0

		<p>shqiptar? Ç'lehtësira po krijohen?</p> <p>Cilat janë disa nga politikat subvencionuese për vreshtarët shqiptarë?</p> <p>Cilat janë shifrat e produkteve të rrushit dhe të verës që janë importuar dhe eksportuar nga 2015 deri më 2020?</p> <p>A jeni vënë në dijeni për ankesat e vreshtarëve shqiptarë? Nëse po, çfarë zgjidhje parashikoni konkretisht?</p>		<p>hartuar dhe miratuar në qeveri, në dhjetor 2020, draftligji “Për vreshtarinë dhe verën”. Sektori është mbështetur përmes: skemave kombëtare, programit IPARD, si dhe promovimit brenda dhe jashtë vendit, në aktivitete të ndryshme, si panairë etj.</p> <p>Përmes skemave kombëtare është mbështetur:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbjellje vreshtash;</li> <li>- Ujitje me pika;</li> <li>- Prodhim fidanë hardhie autoktone;</li> <li>- Linja përpunimi. Nga programi IPARD janë mbështetur: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Krijimi i vreshtave të reja dhe/ose ristrukturimi i atyre ekzistuese;</li> <li>- Ambjente për makineri dhe paisje, ruajtje, etj.;</li> <li>- Sisteme për mbrojtjen kundër breshërit; - Sistem ujitje; - Paisje, etj.</li> </ul> </li> </ul> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkesa</p>		
--	--	---	--	--	--	--

				<p>juaj, për t'ju kthyer përgjigje lidhur me këtë pyetje, i është dërguar INSTAT-it, në adresën <a href="mailto:info@instat.gov.al">info@instat.gov.al</a> pasi është institucioni kompetent për publikimin e të dhënave.</p> <p>Gjatë procesit të gjatë të konsultimit publik lidhur me hartimin e projektligjit të ri për vreshtarinë dhe verën, kemi adresuar një sërë problematikash dhe kërkesash që ka sektori:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Krijimi i një komiteti për vreshtarinë dhe verën (adresuar në ligj);</li><li>- Studimi i zonave të vreshtarisë (adresuar në ligj);</li><li>- Problemet e kontrollit (adresuar në AKU);</li><li>- Probleme me akcizat (në pritje të kërkesës zyrtare për t'u adresuar tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë).</li></ul>		
--	--	--	--	--	--	--



7	22.1.2021	A i ka kontrolluar Shërbimi Veterinar subjektet e shërbimit (bare, restorante dhe hotele) që mbajnë në kafaz kafshë me qëllim ekspozimin e tyre apo që i	27.1.2021	Sipas VKM-së Nr. 509, datë 13.9.2017 <i>“Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit”</i> mbrojtja e faunës së egër përfshihet në	Deleguar	0
		<p>kanë të balsamosura në ambientet e tyre nëse i plotësojnë kushtet higjienosanitare? Nëse po, na informoni për rezultatet e këtyre kontrolleve.</p> <p>A ka pasur raste të gjorbitjes së këtyre subjekteve lidhur me mosplotësimin e kushteve higjieno-sanitare apo shkelje të tjera lidhur me subjektet e shërbimit (bare, restorante dhe hotele) që mbajnë në kafaz kafshë me qëllim ekspozimin e tyre apo që i kanë të balsamosura në ambientet e tyre? Nëse po, na informoni për rezultatet e këtyre kontrolleve.</p>		<p>fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 <i>“Për të drejtën e informimit”</i> kërkesa i është dërguar Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në adresën <a href="mailto:Fludian.Cuka@turizmi.gov.al">Fludian.Cuka@turizmi.gov.al</a>.</p>		

8	25.1.2021	<p>Cili ka qenë plani i marrjes së mostrave dhe analizimi i tyre për vitin 2020, që duhet të raportohet deri në fund të muajit mars 2021?</p> <p>Sa është realizuar ky plan, në aspektin e numrit të mostrave të marra dhe të dërguara për analizë në laboratorin e referencës, ISUV?</p>	28.1.2021	<p>Për zbatimin e programeve kombëtare të monitorimit të mbetjeve dhe për kryerjen e testimeve të produkteve ushqimore me origjinë shtazore është përgjegjës Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të</p>	Deleguar	0
---	-----------	---	-----------	---	----------	---

		<p>Si janë rezultatet e analizave?</p> <p>Nëse ka produkte që paraqesin ende probleme, cilat janë ato?</p> <p>Në këtë kuadër, sa është realizuar nga ISUV plani i analizimit, pra realizimi i analizave për këtë çështje?</p> <p>Sa mostra kanë mbërritur në ISUV dhe sa janë analizuar deri në fund të dhjetorit 2020?</p> <p>A ka pasur ISUV kitet e nevojshme laboratorike për analizimin e të gjitha mostrave të sjella në kuadër të Planit Kombëtar të Monitorimit?</p> <p>A ka pasur shtyrje ose vonesa në tenderime dhe prokurime për kompanitë që do të furnizonin ISUV me kite laboratorike?</p>		<p><i>drejtën e informimit</i>” kërkesa i është dërguar Institutit të Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë në adresën <a href="mailto:brulindacobaj@yahoo.it">brulindacobaj@yahoo.it</a> .</p>		
--	--	---	--	---	--	--

		<p>A i është përgjigjur ISUV në kohë analizave për mostrat e sjella në kuadër të këtij plani?</p> <p>A është i vërtetë fakti se, ISUV ka shkaktuar vonesa dhe pengesa në realizimin e planit vjetor të monitorimit të mbetjeve dhe si pasojë, kjo do të ndodhë dhe me raportimin në Bruksel?</p> <p>Nëse po, për çfarë arsyeje janë vonuar blerjet e kiteve laboratorike dhe zhvillimi i prokurimeve për këtë çështje?</p> <p>A rrezikojmë të kemi pengesa në eksportimin e peshkut, si dhe zgjatje të mëtejme të ndalimit të eksportit për produktet me origjinë shtazore në BE?</p>				
--	--	---	--	--	--	--

9	25.1.2021	Vënia në dispozicion e dokumentacionit të mëposhtëm, në lidhje me shërbimet jashtë vendit për	11.2.2021	Bashkëlidhur dokumentacioni mbi shërbimet jashtë vendit për Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. <a href="#">Dokument 1</a> <a href="#">Dokument 2</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
---	-----------	---	-----------	---	-------------------------------	---

		<p>Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural:</p> <p>Ftesa dhe axhenda e takimeve, dërguar nga pala pritëse dhe shkresa përcjellëse e saj ku përfshihen edhe kostot e mbuluara prej palës pritëse (udhëtim, fjetje, akomodim, ushqim në vlerë monetare etj.).</p> <p>Programin e punës në lidhje me këtë takim ku të argumentohet rëndësia e pjesëmarrjes, numri i pjesëmarrësve, dhe kostot e mbuluara nga pala shqiptare.</p> <p>Urdhërin e shërbimit që miraton kryerjen e shërbimit.</p> <p>Detajimi i kostove që mbulohen nga buxheti i shtetit që shoqërojnë urdhrin.</p> <p>Urdhërin e prokurimit/shpalljen e njoftimit për biletat.</p>		<p><a href="#">Dokument 3</a></p>		
--	--	--	--	-----------------------------------	--	--

		<p>Faturën e biletës së udhëtimit nga agjencia turistike, shoqëruar me rezervimin e gjeneruar nga sistemi i shoqërive ajrore.</p> <p>Formularin e paradhënies (në vlerë monetare) për dieta, akomodim, transport të firmosur nga udhëtuesi dhe Sektori i Financës.</p> <p>Faturën e akomodimit në hotel të gjeneruar nga hoteli dhe firmosur nga udhëtuesi.</p> <p>Faturat që mbështesin shpenzimet për transport.</p> <p>Boarding pass-et e nisjes dhe mbërritjes.</p> <p>Formularin e “Urdhrit Shërbimit për Jashtë Vendi” të plotësuar dhe firmosur pas kthimit në Tiranë.</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		Raport/relacion shërbimi që plotësohet nga pjesëmarrësit pas kthimit nga shërbimi jashtë vendit.				
10	1.2.2021	<p>Sa është vlera e investimeve në Shkodër për përforcimin e argjinaturave në vitin 2020?</p> <p>Kur është bërë investimi i fundit për përforcimin e argjinaturës në Dajç?</p>	5.2.2021	<p>Në zonën e Shkodrës, gjatë vitit 2020 nuk kemi pasur investime në objektet e mbrojtjes nga përmytja.</p> <p>Në vitin 2019, janë investuar rreth 152 milion lekë për rehabilitimin e argjinaturës së lumit Buna, në segmentin Pentar – Luarëz (rreth 6.5 km argjinaturë).</p> <p>Në periudhën 2013 – 2018, janë investuar rreth 280 milion lekë për rehabilitimin e objekteve të mbrojtjes nga përmytja, kryesisht në lumenjtë Buna, Drin dhe Kir.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0



11	8.2.2021	Cila është aktualisht harta e rajonizimit të produkteve bujqësore? Bazuar në nenin 3, pika 3 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, lutemi të na bashkëngjisni dokumentin origjinal të programit të rajonizimit.	11.2.2021	Harta e rajonizimit të bujqësisë është realizuar në vitin 2014, bazuar në një studim të ekspertëve të fushës, në kuadër të iniciativës “Muajt e Bujqësisë Shqiptare”. Bashkëlidhur harta e bujqësisë. <a href="#">Harta</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
----	----------	---	-----------	---	-------------------------------	---

		<p>Cila drejtori apo agjenci përkujdeset për përditësimin e hartës së rajonizimit të produkteve bujqësore?</p> <p>Sa shpesh bëhet përditësimi i hartës së rajonizimit të produkteve bujqësore?</p> <p>Ku publikohen këto të dhëna? Bashkëngjisni linkun përkatës ju lutem.</p>		<p>Sektori i Statistikave në Ministri, grumbullon, përpunon dhe dërgon të dhënat për bujqësisë dhe blegtorinë, në INSTAT për përpunim të mëtejshëm dhe publikim. Të dhënat për prodhimin, sipërfaqet, rendimentet, për kulturat bujqësore, numri i krerëve, sasi të e prodhimit, shpërndarja, për blegtorinë, sipas qarqeve dhe në rang vendi publikohen çdo vit.</p> <p>Të dhënat grumbullohen, përpunohen dhe publikohen çdo vit.</p> <p>Të dhënat për bujqësinë dhe blegtorinë publikon nga INSTAT. <a href="http://www.instat.gov.al">www.instat.gov.al</a></p>		
12	9.2.2021	<p>Dokumentacion mbi privatizimet në ish-Ndërmarrjen Bujqësore Vurg, që ndodhet në Arkivën e MBZHR-së, i cili lidhet me:</p> <p>1. Kontratën e shitblerjes Nr. 7106 rep, Nr. 7072 kol, datë</p>	19.2.2021	<p>Gjatë kërimit të dokumentacionit sipas të dhënave përkatëse pranë Arkivës së MBZHR-së, nuk gjenden dokumentet e kërkuara.</p>	Përgjigja është 0 dhënë e plotë	0

		<p>të lidhur ndërmjet NB Vurg dhe XY;</p> <p>2. Stallat e derrave Metoq, bashkëlidhur vendimet e ishKKKP Sarandë dhe hartat përkatëse;</p> <p>3. Stallat e lopëve Metoq, bashkëlidhur vendimet e ishKKKP Sarandë dhe hartat përkatëse.</p> <p>Një konfirmim nëse ka privatizime të tjera apo kontrata të shitblerjes, në parcelën “Shënkoll” (emërtimi i vjetër) në zonën e stallave tek peshorja me emërtimin grumbullim silazhi, e cila gjendet në rrugën kryesore në drejtim të Ksamilit sipas vendimeve të ish-KKKP Sarandë dhe hartave përkatëse bashkëlidhur.</p>				
13	10.2.2021	Jashtë objektit të punës	22.2.2021		Përfunduar	0

14	15.2.2021	A ekziston një projekt konkret për zhvillimin e infrastrukturës në fshatin Zvërnec, në kuadër të programit 100 fshatrat?	22.2.2021	Me miratimin e Ligjit Nr. 99/2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019” zbatimi i investimeve të programit 100 fshatrat (Programit të Integruar	Deleguar	0
		A ka plan për investime në infrastrukturë në fshatin Zvërnec për vitin 2021 apo në vitet në vazhdim, në kuadër të programit 100 fshatrat?		të Zhvillimit Rural) i ka kaluar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.  Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar Fondit Shqiptar të Zhvillimit në adresën <a href="mailto:sdemko@albaniandf.org">sdemko@albaniandf.org</a> .		
15	15.2.2021	Informacion mbi shpenzimet e MBZHR-së për kancelari dhe mobilim zyresh, si dhe mbi shpenzimet për makina, të specifikuar për çdo vit, duke filluar nga viti 2014 deri në vitin 2020.	26.2.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Tabela e shpenzimeve</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
16	19.2.2021	Jashtë objektit të punës	24.2.2021		Përfunduar	0

17	25.2.2021	<p>Kopje të dosjes së dhënies me qira të tokës bujqësore me sipërfaqe 1146 hektarë në Topojë, Qarku Fier, për kompaninë “Agri Product Europe”.</p> <p>Informacion mbi ecurinë e investimit nga kompania “Agri Product Europe” deri më sot si dhe një kopje të çdo dokumenti tjetër rreth ankandit, përfshirë subjektet e interesuara, përfaqësuesit e subjekteve, projektet e tyre,</p>	23.3.2021	<p>Ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe shoqërisë “Agri Products Europe” shpk është lidhur Kontrata Nr. 950 rep, Nr. 307/1 kol, Nr. 4220 prot, datë 15.5.2015.</p> <p>Lidhur me këtë kontratë Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në process gjyqësor me shoqërinë “Agri Products Europe” shpk.</p>	Përgjigja është dhënë e kufizuar	0
----	-----------	---	-----------	---	----------------------------------	---

		vendimmarrjen e anëtarëve të Bordit të Qiradhënies së Tokave Bujqësore etj.		<p>Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në nenin 17, pika 2, shkronja “dh” përcakton se e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj barazisë së palëve në një process gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor.</p> <p>Për sa më sipër, për shkak se procesi gjyqësor nuk ka përfunduar, nuk mund t’ju vendosim në dispozicion pjesën tjetër të dokumentacionit, të kërkuar nga ana juaj.</p> <p>Bashkëlidhur Kontrata Nr. 950 rep, Nr. 307/1 kol, Nr. 4220 prot, datë 15.5.2015. <a href="#">Kontrata</a></p>		
18	8.3.2021	<p>Kur ka nisur funksionimi i Bursës Shqiptare Bujqësore?</p> <p>Cila drejtori apo agjenci përkujdeset për përditësimin e Bursës Shqiptare Bujqësore?</p>	25.3.2021	Bursa Shqiptare Bujqësore nuk ka nisur të funksionojë.	Përgjigja është 0 dhënë e plotë	0

		<p>Në cilat qytete po funksionon aktualisht Bursa Shqiptare Bujqësore?</p> <p>Ku publikohen të dhënat mbi BSHB? Bashkëngjisni linkun përkatës ju lutem.</p>			
19	12.3.2021	<p>1. Shqipëria është vend kandidat për në Bashkimin Europian dhe pritet në muaj pasues takimi i parë ndërqeveritar për t'a shtyrë para këtë axhendë. Një ndër kushtet me rëndësi për vijimin e këtij progresi integrues është edhe Kapitulli 12 i Sigurisë Ushqimore dhe përafrimi i legjislacionit. Në çfarë faze ndodhet Shqipëria veçanërisht për këtë kapitull dhe si po përparon ky përafrim?</p> <p>2. Si përkthehen vendimmarrjet në fushën e sigurisë ushqimore të BE-së në Shqipëri, si në zbatim ashtu edhe në miratim?</p> <p>3. Shqipëria prej shumë vitesh nuk po eksporton dot produkte me origjinë shtazore. A ka një adresim</p>	23.3.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Kapitulli 12</a>	Përgjigja është 0 dhënë e plotë

		<p>konkret të këtij shqetësimi dhe a është duke u plotësuar ky kusht komplekst për realitetin shqiptar, si pjesë e Kapitullit 12?</p> <p>4. Hartimi i legjislacionit por edhe kontrolli i sigurisë ushqimore bëhen nga i njëjti autoritet, Ministria e Bujqësisë. Ekspertët e cilësojnë në kundërshtim me rekomandimet e BE dhe konfliktuale si praktikë. Cili është mendimi juaj?</p> <p>5. Progres – raporti i vitit 2020 për Shqipërinë la sërish në fuqi rekomandimet e vitit 2019 për sigurinë ushqimore pasi shumica prej tyre nuk ishin plotësuar. A ka ndonjë prej kushteve të vendosura që mund të jetë plotësuar gjatë 6 muajve të fundit?</p> <p>6. Sa pengon informaliteti i fermerëve në zbatimin e analizimit të rriskut të sigurisë ushqimore</p>			
--	--	--	--	--	--



		dhe gjurmueshmërisë së produkteve dhe sa larg e				
--	--	--	--	--	--	--

		<p>mban ky fakt plotësimin e kushteve të këtij kapitulli?</p> <p>7. Buxhetimi i munguar dhe ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore a mbetet një problem që mund t'i kushtojë kohë vendit për plotësimin e kushteve të kërkuara?</p>				
20	23.3.2021	<p>Në fshatin Hormovë, Tepelenë ekziston një memorial. Një grup atdhetarësh kanë siguruar fondin dhe projektin me financim privat që ta rikonstruktojnë.</p> <p>Kanë marr miratimin në Këshillin Bashkiak Tepelenë, por, ka dal pengese një hapsirë rreth 250 m<sup>2</sup> që është tokë bujqësore dhe është në pronësi të Ministrisë.</p> <p>Kërkohej konvertim në tokë truall.</p> <p>A është në dijeni Ministria? Si do veprohet në mënyrë që ky memorial të kthehet në një atraksion turistik?</p>	23.3.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Informacion</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
21	23.3.2021	<p>Kërkohej një intervistë me një nga personat përgjegjës për ndjekjen e ecurisë së</p>	25.3.2021	Me miratimin e Ligjit Nr. 99/2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019” zbatimi i	Deleguar	0

		<p>programit 100 fshatrat. Në pamundësi të një interviste kërkohet informacion mbi pyetjet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Sa fshatra kanë përfituar deri tani nga ky program dhe cilët janë fshatrat?</li> <li>2. Në cilën fushë janë investimet më të mëdha?</li> <li>3. Sa fonde janë investuar?</li> <li>4. A vazhdon më si projekt, pasi periudha e zhvillimit të tij do shtrihej nga 2018 deri në 2020?</li> </ol>	<p>investimeve të programit 100 fshatrat (Programit të Integruar të Zhvillimit Rural) i ka kaluar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>” kërkesa i është dërguar Fondit Shqiptar të Zhvillimit në adresën <a href="mailto:sdemko@albaniandf.org">sdemko@albaniandf.org</a>.</p>	
--	--	---	--	--

22	24.3.2021	<p>1. Cili është numri i fermave që ndodhen në Shqipëri? (<i>Ju lutem bashkangjisni dokumentat ligjore që provojnë këtë fakt.</i>)</p> <p>2. Çfarë kapacitetesh ofrojnë këto ferma referuar numrit të kafshëve/shpendëve</p>	2.4.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Informacion</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
----	-----------	--	----------	---	-------------------------------	---

	<p>përkatëse? <i>(Ju lutem bashkangjisni dokumentat ligjore që provojnë këtë fakt.)</i></p> <p>3. Cili është ushqimi që përdoret në këto ferma dhe në cilat kritere kryhet përzgjedhja e tij? <i>(Ju lutem bashkangjisni dokumentat ligjore që provojnë këtë fakt.)</i></p> <p>4. Referuar destinacionit gjeografik, si rezulton shpërndarja e këtyre fermave pra vendodhja ekzakte e tyre? <i>(Ju lutem bashkangjisni dokumentat ligjore që provojnë këtë fakt.)</i></p> <p>5. Cilat janë objektivat tuaja parashikuar në legjislacionin shqiptar referuar rritjes së cilësisë për këto ferma në Shqipëri? <i>(Ju lutem</i></p>			
--	--	--	--	--

		<p><i>bashkangjisni dokumentat ligjore që provojnë këtë fakt.)</i></p> <p>6. Si kryhet mbrojtja e konsumatorit referuar cilësisë së produkteve që ofrojnë këto ferma? <i>(Ju lutem bashkangjisni dokumentat ligjore që provojnë këtë fakt.)</i></p>				
23	1.4.2021	<p>Si mund të kontrollohet aplikimi i bërë për mbështetjen për karburant si fermer?</p> <p>Sa është kohëzgjatja e procedurës?</p>	6.4.2021	Referuar udhëzimit për administrimin e skemës së naftës për bujqësinë, përgjigja për rezultatin e aplikimit dërgohet brenda 30 ditësh nga përfundimi i periudhës së aplikimeve, që është data 30 prill 2021. Kjo përgjigje jepet nga Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor që mbulon qarkun ku është bërë aplikimi.	Përgjigja është dhënë e plotë	0
24	2.4.2021	1. A është reduktuar tatimi mbi vlerën e shtuar për farërat, fidanët, materialin gjenetik shtazor, plehërat kimike, pesticidet, vaksinat e	14.4.2021	<p>Bashkëlidhur informacioni</p> <p><a href="#">Dokument 1</a></p> <p><a href="#">Dokument 2</a></p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>blegtorisë? Kur ka nisur të aplikohet dhe në çfarë mase është reduktuar?</p> <p>2. A është vendosur në funksion qendra e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së inputeve bujqësore? Në çfarë date?</p> <p>3. A furnizohet sot me ujë 24 orë çdo parcelë e tokës bujqësore të punueshme? Sa është sipërfaqja që mbulohet? Cilat zona specifikisht mbulohen?</p> <p>4. Sa është vlera e investimeve për sistemin e kullimit dhe vaditjes nga viti 2013 deri në vitin 2020 (specifikisht për secilin vit)?</p> <p>5. Çfarë është bërë për zbatimin e Ligjit Nr. 7501? A</p>		<p><a href="#">Dokument 3</a></p>		
--	--	---	--	-----------------------------------	--	--

		<p>ka marrë ky ligj sot zbatimin e plotë?</p> <p>6. Çfarë është bërë me sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të blegtorisë? A funksionon sot ky regjistër?</p> <p>7. A ka përfunduar harta e rajonizimit të kulturave të ndryshme bujqësore dhe e racave të ndryshme? Nëse po, ku mund t'a gjejmë sot këtë informacion?</p> <p>8. A përfitojnë anijet e peshkimit nga skema e naftës pa akcizë? Nga cili vit ka nisur të aplikohet? Sa subjekte përfitojnë?</p> <p>9. A është i hapur eksporti për molusqet drejt vendeve të</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		<p>BE-së? Kur ka nisur aplikimi?</p> <p>10. Sa është sipërfaqja e shtuar e gjelbëruar në zonat urbane? (specifikisht sipas zonave nga viti 2013 deri në vitin 2020)?</p> <p>11. Sa është vlera e investimeve në zonat rurale në mbështetjen e eksportit bujqësor, në përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat rurale, mbështetjen e fermerëve dhe rritjen e aksesit në tregje, nga viti 2017 deri në vitin 2020 (specifikisht sipas zonave)?</p> <p>12. Sa është numri i paisjeve të monitorimit të cilësisë së ajrit në vendin tonë? Ku janë të vendosur?</p>				
--	--	---	--	--	--	--



25	6.4.2021	<p>1. Në maj të 2020 kryeministri Edi Rama njoftoi se qeveria po bën gati draftligjin për lejimin e kultivimit të kanabisit për arsye mjekësore në vend. Çfarë po ndodh me këtë proces dhe a keni nisur punën për hartimin e projektligjit?</p> <p>2. Në Projektligj, sipas qeverisë do të marrin pjesë edhe ekspertë të huaj nga shtete të tjera. Cilit shtet i jeni referuar për një projektligj të tillë?</p> <p>3. Cila do të jetë zona ekskluzive ku do të kultivohet kanabisi për qëllime mjekësore?</p> <p>4. Si do të harmonizohet me politikat e tjera në bujqësi?</p> <p>5. Për dy vite në rast kultivimi të kanabisit për qëllime</p>	16.4.2021	<p>Ka filluar procesi i punës, në nivel teknik me përfshirjen e disa ministrive për shqyrtimin e disa modeleve dhe praktikave në vende të ndryshme në rajon dhe më gjerë, duke synuar marrjen e eksperiencave nga vende të ndryshme në rajon, ashtu dhe në vende të Bashkimit European apo vendeve të tjera me institucione të konsoliduara, me qëllim evitimin e problematikave të hasura në praktikë në këto vende dhe përfitimin e praktikave të suksesshme. Qëllimi është krijimi i kushteve për të sjell punësim, zhvillim ekonomik dhe të ardhura në buxhetin e shtetit, por pa cënuar aspekte që lidhen me rendin publik, besueshmërinë në këtë proces, dhe garantimin e suksesit, e për këto arsye procesi i hartimit të ligjit ka marrë një kohë të gjatë.</p> <p>Në momentin që do të ketë një ecuri më të madhe të grupit të</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
----	----------	--	-----------	---	-------------------------------	---

		<p>mjekësore, qeveria ka planifikuar të fitojë 2 mld euro, si do të arrihet kjo?</p> <p>6. Ku është parashikuar të ngrihet fabrika e përpunimit të kanabisit, pas procesit të kultivimit?</p> <p>7. Kur keni parashikuar ta shtroni për diskutim publik projektligjin për kultivimin e kanabisit për qëllime mjekësore?</p>		<p>punës në hartimin e një draft-ligji, atëherë do të ketë komunikime publike dhe me mediat.</p>		
26	15.4.2021	<p>Për periudhën kohore 25 mars - 25 prill:</p> <p>1. A ka marrë ministri i institucionit leje vjetore?</p> <p>2. A ka pasur urdhër shërbimi për të lëvizur nëpër qytete të ndryshme?</p>	7.5.2021	<p>Për periudhën 25 mars – 25 prill 2021 ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka kryer leje të zakonshme dhe nuk ka pasur urdhër shërbimi. Gjatë kësaj periudhe ministrja e institucionit ka qenë në detyrë në përmbushje të detyrave funksionale. Kujtojmë këtu ndjekjen e skemës së naftës për fermerët në rrethe të ndryshme.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>3. Nëse ka pasur urdhër shërbimi, cili ka qenë argumenti i këtij urdhëri?</p> <p>Ju lutem na vini në dispozicion të gjithë dokumentacionin përkatës.</p>				
27	4.5.2021	Kopje e qëndrimit zyrtar të institucionit tuaj lidhur me propozimin e ardhur për ndërtimin e ujësjellësit për furnizimin me ujë të fshatrave të njësisë administrative Derjan dhe Rukaj Loti 1.	5.5.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Informacion</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
28	27.4.2021	<p>Kopje të:</p> <p>1. Urdhrit të Ministrit Nr. 422, datë 17.12.2009 “Për miratimin e Rregullores “Mbi kushtet për regjistrimin e riprodhuesve racë – pastër të specieve të gjedhit, dhenve, dhive, kuajve, derrave racë –</p>	11.5.2021	<p>Në Arkivën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural janë gjetur aktet bashkëlidhur:</p> <p>1. Urdhri i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Nr. 422, datë 17.12.2009 “Për miratimin e Rregullores “Mbi kushtet për regjistrimin e</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p><i>pastër dhe hibridë në librin gjenealogjik</i>”;</p> <p>2. Urdhrit të Ministrit Nr. 403, datë 15.11.2007 “<i>Mbi miratimin e Rregullores “Mbi përfshirjen e disa sëmundjeve në kuaj e në bletë në listen e sëmundjeve të lajmërueshme</i>”;</p> <p>3. Rregullore “<i>Mbi masat e kontrollit dhe luftimit të sëmundjes afrikane të kuajve</i>”;</p> <p>4. Rregullore “<i>Mbi kushtet zooteknike e gjenealogjike që administrojnë tregtinë e kuajve</i>”;</p> <p>5. Rregullore në lidhje me metodat për identifikimin e kuajve.</p>		<p><i>riprodhuesve racë – pastër të specieve të gjedhit, dhenve, dhive, kuajve, derrave racë – pastër dhe hibridë në librin gjenealogjik</i>”;</p> <p><a href="#">Urdhër nr.422-datë 17.12.2009</a></p> <p>2. Urdhri i Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Nr. 403, datë 15.11.2007 “<i>Për miratimin e listës së territoreve nga të cilat është i autorizuar importi i disa specie peshqish të gjallë, vezëve të tyre dhe gametave të destinuara për mbarështrim në Shqipëri dhe në Komunitetin European</i>”;</p> <p><a href="#">Urdhër nr.403-datë 15.11.2007</a></p> <p>3. Urdhri i Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave Nr. 218, datë 14.4.2016 “<i>Për miratimin e Rregullores “Mbi masat për</i></p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p><i>kontrollin dhe luftimin e sëmundjes afrikane të kuajve;</i></p> <p><a href="#">Urdhër nr.218 datë 14.4.2016</a></p> <p>4. Urdhër i Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave Nr. 221, datë 14.4.2016 “<i>Për miratimin e Rregullores “Mbi metodat e identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve njëthundrakë”.</i></p> <p><a href="#">Urdhër nr.221 datë 14.4.2016</a></p>		
29	7.5.2021	<p>1. Fermerët e vegjël në Bashkinë e Kukësit çfarë kanë përfituar nga subvencionet?</p> <p>2. Nafta për këta fermerë të vegjël të kësaj bashkie, sa përqind ulje të çmimit ka pësuar?</p>	14.5.2021	<p>1. Institucioni kompetent për ndjekjen e procedurave për përfitimin e subvencioneve është Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “<i>Për të drejtën e informimit</i>” pyetja e parë i është dërguar Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në adresën <a href="mailto:info@azhbr.gov.al">info@azhbr.gov.al</a>.</p>	<p>Pyetja e parë është deleguar.</p> <p>Për pyetjen e dytë përgjigja është dhënë e plotë.</p>	0

				<p>2. Sipas pikës 6, Kreu II, të Udhëzimit të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 1, datë 8.1.2021 “<i>Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të skemës së mbështetjes me naftë për bujqësinë</i>”, të ndryshuar, përfitimi i sasisë së naftës falas për sipërfaqen që kultivohet, është sim ë poshtë:</p> <p>a) Aplikuesit me sipërfaqe deri në 10 ha, përfitojnë 100% sasinë e naftës sipas normativave të përcaktuara në Aneksin 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.</p> <p>b) Aplikuesit me sipërfaqe mbi 10 ha, për sipërfaqe mbi 10 ha, marrin sasinë e naftës me normativë të korrektuar/reduktuar kur sasia e naftës në dispozicion nuk</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				plotëson të gjithë kërkesën për këto sipërfaqe.		
30	7.5.2021	<p>1. Ku është aktualisht procesi me investimet në kuadër të programit “100 fshatrat turistik”?!</p> <p>2. Në cilat zona konkretisht ka përfunduar investimi në fshatrat turistik? Çfarë është bërë konkretisht në sektor të caktuar?!</p> <p>3. Sa zona kanë mbetur ende pa u trajtuar nga ky program, flasim në fshatrat e përcaktuar nga qeveria si turistik?!</p> <p>4. Sa bujtina dhe biznese agroturistike janë ndihmuar në këto vite?!</p>	19.5.2021	<p>- Lidhur me pyetjen po zhvillimi i kapitalit social dhe njerëzor, (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit si dhe shoqërinë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe jetesës në fshat, etj, a është realizuar dhe nëse po, ku konkretisht, ju sqarojmë se:</p> <p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me grupet e interesit dhe kryesisht Rrjetin Shqiptar për Zhvillimin Rural, ka iniciuar hartimin e Ligjit “Mbi organizimin dhe funksionimin e Grupeve Vendore të Veprimit”, i cili ka kaluar fazën e konsultimit</p>	<p>Pyetja 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9, 10 dhe 11 është deleguar.</p> <p>Për pyetjen 7 dhe 8 përgjigja është dhënë e plotë.</p>	0

		<p>5. Në sa fshatra turistik dhe në cilat zona konkretisht është investuar në infrastrukturë rrugore, mjedisore, turistike dhe kulturore?!</p> <p>6. A është arritur të kryhet zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike, nëse po, në cilat zona konkretisht?!</p> <p>7. Po zhvillimi i kapitalit social dhe njerëzor, (mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit si dhe shoqërinë civile në zonat rurale, trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë, mbështetje të trashëgimisë kulturore, mbështetje për promovimin e traditave dhe jetesës në fshat, etj, a është realizuar?! Nëse po, ku konkretisht?</p>		<p>publik, është dërguar dhe ridërguar për mendim tek ministritë e linjës dhe aktualisht është drejt fazës përfundimtare, drejt miratimit.</p> <p>Lidhur me pyetjen Programi i Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i 100 fshatrave, do të zbatohet në periudhën 2018-2020, a ka një shtyrje të këtij afati dhe nëse po, deri kur, ju sqarojmë se:</p> <p>Nuk ka shtyrje të afatit.</p> <p>Pyetjet e tjera, bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i janë dërguar Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në adresat elektronike përkatëse</p>		
--	--	---	--	--	--	--



		<p>8. Programi i Integruar për Zhvillimin Rural – Programi i 100 fshatrave, do të zbatohet në periudhën 2018-2020, a ka një shtyrje të këtij afati?! Dhe nëse po, deri kur?</p> <p>9. Kush nga ministritë, bashkitë, donatorët ka financuar për projektin e 100 fshatrave , dhe nëse mund të kemi një ndarje?!</p> <p>10. Pjesë e programit të 100 fshatrave ka qenë gjithashtu edhe krijimi i Rrjetit të inkubatorëve të produkteve tradicionale, a është bërë kjo deri me tani?</p> <p>11. Po krijimi i rrjetit të markatave/dyqaneve të produkteve shqiptare dhe tradicionale?</p>		<p><a href="mailto:sdemko@albaniandf.org">sdemko@albaniandf.org</a> dhe <a href="mailto:info@azhbr.gov.al">info@azhbr.gov.al</a> .</p>		
--	--	---	--	--	--	--

31	20.5.2021	Ka ndonjë projekt për fshatin Dardhë, Qarku Korçë?	26.5.2021	<p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka një projekt specifik për fshatin Dardhë.</p> <p>Referuar VKM-së Nr. 21, datë 12.1.2018 “Për disa shtesa në Vendimin Nr. 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014 – 2020”, rezulton se fshati Dardhë, Qarku Korçë, është bërë pjesë e Programit të Integruar për Zhvillimin Rural - Programit të 100 fshatrave.</p> <p>Me miratimin e Ligjit Nr. 99/2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019”, zbatimi i investimeve të programit 100 fshatrat (Programit të Integruar të Zhvillimit Rural) i ka kaluar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
----	-----------	--	-----------	---	-------------------------------	---

				Për informacion më të detajuar mund t'i drejtoheni Fondit Shqiptar të Zhvillimit.		
32	8.6.2021	Informacion i 4 – 5 viteve të fundit rreth prodhimit të luleshtrydheve në vend (hapësira/sasia), zona/rrethet me të mbjella.	8.6.2021	<a href="http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_BU_AFC/BU04/?rxid=cbcd5a5e-90df-434c-bf9c-1b85adce79f8">http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START_BU_AFC/BU04/?rxid=cbcd5a5e-90df-434c-bf9c-1b85adce79f8</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
33	21.6.2021	<p>1. Kopje të Urdhrit të Brendshëm të ministrisë që ju drejtoni “Për ngritjen e grupit të punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor” sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe Udhëzimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil “Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”;</p> <p>2. Kopje të Rregullores së brendshme të veprimtarisë së grupit të punës të ngritur sipas pikës 1.</p>	1.7.2021	<p>Bashkëlidhur informacioni</p> <p><a href="#">Dokument 1</a></p> <p><a href="#">Dokument 2</a></p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>3. A ka patur nëpunës të administratës që ju drejtoni dhe institucioneve në varësi, të cilët kanë qenë kandidatë për deputet në zgjedhjet e datës 25 prill 2021?</p> <p>3.1. Nëse po, lutemi na specifikoni emrat e këtyre nëpunësve?</p> <p>3.2. A kanë kërkuar pezullim nga detyra nëpunësit e përfshirë në pikën 3.1?</p> <p>3.3. Nëse po, lutemi kopje akteve të pezullimit të secilit prej tyre.</p> <p>4. A kanë kërkuar nëpunës, civilë ose jo, të institucionit që ju drejtoni të kryejnë funksione në administratën zgjedhore?</p> <p>4.1. Nëse po, sa nëpunës janë autorizuar?</p>				
--	--	---	--	--	--	--

		<p>4.2. Lutemi, na vini në dispozicion një kopje të autorizimit, për çdo nëpunës të administratës shtetërore në varësinë tuaj.</p> <p>5. A ka pasur raste të konstatimit të shkeljeve nga grupi i punës?</p> <p>5.1. Nëse po, lutemi kopje të procesverbalit të konstatimit të shkeljeve përkatëse.</p> <p>5.2. Si është proceduar në vazhdim nga grupi i punës lidhur me shkeljen e konstatuar, dhe a ka ndonjë vendim apo procedim të ndërmarrë lidhur me shkeljen e konstatuar?</p> <p>6. Sa është numri i nëpunësve civilë në administratën e institucionit që ju drejtoni dhe në institucionet në varësi, të kategorizuar sipas secilit</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		<p>institucion, dhe sa i atyre që janë në proces marrje të këtij statusi?</p> <p>7. Sa është numri i nëpunësve publikë, të cilët nuk gëzojnë statusin e nëpunësit civil, në administratën e institucionit që ju drejtoni dhe në institucionet në varësi, të kategorizuar sipas secilit institucion?</p>				
34	21.6.2021	<p>1. A ka zhvilluar Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, procedura të konkurrimit publik për dhënien e së drejtës së përdorimit të basenit ujqor të Kallëngës Vlorë? Nëse po, kopje të dokumentacionit të prokurimit.</p> <p>2. A ka lidhur Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural kontratë me shoqërinë “Alb Ligatina” për shfrytëzimin e basenit ujqor të Kallëngës/nëse po më vini në</p>	1.7.2021	<p>1. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka zhvilluar procedurën e konkurrimit publik për dhënien e së drejtës së peshkimit artizanal me dajlan në Zonën Ligatinore të Kallëngës (Novoselë, Vlorë). Njoftimi për konkurrimin publik është botuar në Buletinin Nr. 8, datë 2.3.2020 të Agjencië së Prokurimit Publik, në linkun: <a href="http://app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=494ea0c4-7ee9-4828-al4646-d952d59bb0c7">http://app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=494ea0c4-7ee9-4828-al4646-d952d59bb0c7</a> faqe 289-293.</p>	Përgjigja është dhënë e kufizuar	0

		<p>dispozicion një kopje të kontratës dhe të gjithë dokumentacionit mbi të cilin është bazuar lidhja e kësaj kontrate.</p> <p>3. Në bazë të nenit 3.1, të Ligjit Nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, i ndryshuar, në të cilën shprehimisht ligjvënësi ka parashikuar që: “Janë pjesë e ZPA-së, zonat në të cilat zhvillohet aktiviteti i akuakulturës në struktura në pronësi shtetërore”, lutem shpjegime të hollësishme cili autoritet ka dhënë leje për shfrytëzimin e tokës private të pronarit X Y dhe bazën ligjore ku është mbështetur ky autorizim.</p> <p>4. Në bazë të nenit 8, pika 1, të Ligjit Nr. 103/2016, i ndryshuar, kërkoj kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave për shfrytëzimin e</p>		<p>2. Në konkurrimin publik të zhvilluar më datë 10.3.2020, me vendim të Komisionit të Vlerësimit të Kërkesave, u shpall fitues subjekti juridik “Alb Ligtina” sh.p.k. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka lidhur me këtë subjekt Kontratën Nr. 3706, datë 22.5.2020 “Për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit/akuakulturës” me afat 10 vjeçar, të cilën e gjeni bashkëlidhur.</p> <p>Referuar Nenit 17, paragrafi 1, shkronja “b” të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, planin e biznesit të shoqërisë “Alb Ligatina” sh.p.k nuk mund t’ua vendosim në dispozicion sepse përmban të dhëna që çënojnë sekretin tregtar.</p> <p>3. Subjektit i është dhënë e drejta e zhvillimit të aktivitetit të peshkimit artizanal me dajlan,</p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>basenit ujqor tē Kallēngēs tē shoqēruar me hartēn pērkatēsē.</p> <p>5. Nē bazē tē nenit 34 tē Ligjit Nr. 103/2016, kērkqj kopje tēraportit tē ndikimit nē mjedis tē paraqitur nga shoqēria “Alb Ligatina” pēr shfrytēzimin e basenit ujqor tē Liqenit tē Kallēngēs.</p>		<p>dhe jo e drejta e zhvillimit tē peshkimit tē akuakulturēs. Pra, ajo zonē peshkimi nuk trajtohet nēpērmjet ligjit tē cituar nga ana juaj pēr akuakulturēn dhe nuk ka tē bējē me ZPA. Ministria e Bujqēsiē dhe Zhvillimit Rural ka lidhur kontratēn e sipērcituar me subjektin vetēm pēr zonēn ujqore ligatinore dhe jo shfrytēzimin e sipērfaqeve tokēsore private apo shtetērore.</p> <p>4. Vendimi i Kēshillit tē Ministrave pēr shpalljen e ZPA (Zonave tē Pērcaktuara pēr Akuakulturē) nxirret pēr aktivitetin e akuakulturēs dhe jo pēr zonat ujqore tē peshkimit. Bashkēlidhur harta pērkatēsē.</p> <p>5. Raporti i ndikimit nē mjedis (VNM) dhe leje mjedisore kērkohet pēr aktivitetet akuakulturē intensive dhe jo pēr aktivitet peshkimi.</p>		
--	--	--	--	---	--	--



35	30.6.2021	<p>1. Kur nisi Skema e Naftës pa taksa për fermerët?</p> <p>2. Sa fermerë kanë aplikuar deri më tani?</p> <p>3. Sa prej tyre kanë përfituar nga kjo skemë?</p> <p>4. Kjo politikë mbeshtetëse për sa kohë do të zgjasë?</p> <p>5. Cilët fermerë mund të përfitojnë nga skema e naftës?</p> <p>6. A janë të përfshirë fermerë të fushave të ndryshme?</p> <p>7. Do të bëni ndryshme në Skemën e Naftës?</p> <p>8. Si e ka ndihmuar kjo skemë fermerin shqiptar?</p> <p>9. Për të qenë pjesë e Skemës së Naftës çfarë kushtesh duhet të plotësosh?</p>	6.7.2021	<p>Bashkëlidhur informacioni</p> <p><a href="#">Informacion</a></p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
----	-----------	--	----------	---	-------------------------------	---

36	1.7.2021	<p>1. Sa ka qenë vlera e investimeve nga viti 2014 deri në vitin 2021 për bujqësinë (specifikisht për secilin vit)? Si janë kanalizuar këto investime sipa secilit sektor?</p> <p>2. Sa është vlera e subvencioneve që janë marrë nga fermerët shqiptarë?</p> <p>3. Sa fermerë/ferma ka pasur Shqipëria nga 2014 deri në 2021 (specifikisht për secilin vit)?</p> <p>4. Sa fonde ka dhënë BE nga investimet që janë bërë në Shqipëri për bujqësinë?</p> <p>5. Sa është investimi nga shteti shqiptar?</p>	15.7.2021	<p>Lidhur me pyetjet 1, 2, 4 dhe 5, bashkëlidhur gjeni tabelat me të dhënat përkatëse, mbështetur në vlerat e disbursimeve të vëna në dispozicion nga DEL i BE në Tiranë për vitet 2014 – 2021 për të cilat MBZHR ka qenë përfituese e investimeve sipas sektorëve.</p> <p><a href="#">Informacion</a></p> <p>Lidhur me pyetjen 3 (Sa fermerë/ferma ka pasur Shqipëria nga 2014 deri në 2021, specifikisht për secilin vit), ju bëjmë me dije se, ky është indikator makro që prodhohet nga INSTAT. Të dhënat mund të aksesohen në databazën statistikore të INSTAT, Tema Census Bujqësor, në linkun: <a href="http://www.instat.gov.al/al/tema_t/censet/censusi-i-bujq%C3%ABsis%C3%AB/#tab2">http://www.instat.gov.al/al/tema_t/censet/censusi-i-bujq%C3%ABsis%C3%AB/#tab2</a>.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
----	----------	---	-----------	--	-------------------------------	---

37	2.7.2021	Informacion për procedurën që duhet ndjekur për të marrë me qira tokën në pronësi të shtetit, me vendndodhje në fshatin Kameras, Njësia Administrative Fushë – Krujë, Bashkia Krujë, për të mbjellë plantacione të ndryshme.	13.7.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Informacion</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
38	7.7.2021	<p>1. Sa është numri i tregjeve të licencuara në Shqipëri për shitjen e kafshëve të gjalla?</p> <p>2. Sa tregje nuk përmbushin standartet?</p> <p>3. Sa tregje janë mbyllur në një hark kohor 1 – 3 vitet e fundit?</p> <p>4. Sa gjoba janë vënë në një hark kohor 1 – 3 vitet e fundit?</p>	14.7.2021	<p>Referuar VKM-së Nr. 230, datë 20.3.2013 “Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore”, përcaktimi i vendndodhjes së tregjeve të kafshëve të gjalla dhe administrimi i shërbimit veterinar pranë tyre është detyrë e strukturave veterinare të njëjësive të qeverisjes vendore.</p> <p>Njësitë e qeverisjes vendore verifikojnë dhe mbikëqyrin që tregjet të funksionojnë sipas legjislacionit në fuqi për fushën e veterinarisë, legjislacionit në fuqi për subjektet tregtare, si dhe</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		5. Sa është shuma e gjobave për operimin e çdo tregu të paligjshëm?		të legjislacionit për licencimin e aktiviteteve.  Për sa më sipër, kërkesën duhet t'ia dërgoni bashkisë që mbulon territorin, për të cilin interesoheni të informoheni.		
39	13.7.2021	Procedura e lidhjes së kontratës për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit/akuakulturës.  Duhet më parë të lidh marrëveshje me bashkinë apo të paraqitem në ministri për të bërë kërkesën për përdorimin e ujëmbledhësit për aktivitet peshkimi?	14.7.2021	Pasi bëhet shpallja e ujëmbledhësve për konkurrim publik në APP, nëse shpalleni fitues në procedurën e konkurimit publik për të zhvilluar aktivitetin “Ripopullim & Peshkim” në një ujëmbledhës të caktuar (procedura e konkurimit zhvillohet nëpërmjet aplikimit/ngarkimit të dokumentacionit në mënyrë elektronike), pas publikimit të njoftimit se jeni fitues në Buletinin e Njoftimeve Publike në Agjencinë e Prokurimit Publik, në fillim duhet të lidhni akt – marrëveshjen për përdorimin e ujit me bashkinë dhe më pas të paraqiteni në	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				ministri për të lidhur akt – marrëveshjen/kontratën me MBZHR.		
40	19.7.2021	<p>1. Dokumentet e fillimit të procedurës të miratuara nga titullari, sipas VKM-së Nr. 712/2013, të ndryshuar, ku përfshihen kopje të dokumentave të vlerësimit të kërkesave për zhvillimin e veprimtarisë së peshkimit në ujërat e brendshme të kënetës së Kallëngës së bashku me vlerësimin e statusit të objektit ujor të kërkuar, procesverbalin e zhvillimit të konkurrimit, të hartuar nga Komisioni i Vlerësimit dhe raportin përfundimtar të vlerësimit të fituesit.</p> <p>2. Kopje të udhëzimit të ministrit, bazuar në pikën 16/1 të VKM-së Nr. 712, datë 31.7.2013.</p>	11.8.2021	<p>1. Në nenin 17, paragrafi 2, shkronja “e” të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përcaktohet se:</p> <p>“E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:</p> <p>... e) këshillimin dhe diskutimin paraprak brenda ose midis autoriteteve publike për zhvillimin e politikave publike;”</p> <p>Dokumentacioni i kërkuar nga ana juaj lidhet me diskutimin paraprak të Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të kërkesave të paraqitura për konkurrim publik e për rrjedhojë nuk mund t’jua vendosim në dispozicion.</p> <p>Bashkëlidhur gjeni:</p>	Përgjigja është dhënë e kufizuar	0

		<p>3. Kopje të raporteve të monitorimit të vazhdueshëm të kontratës së lidhur midis MBZHR dhe subjektit “Alb Ligatina” sh.p.k.</p> <p>4. Kopje të rregullores së miratuar nga ministri në të cilën është përcaktuar lloji i peshkut, apo grupet e llojeve të peshkut, që peshkohen/zien në det dhe në ujrat e brendshme, si dhe zonat respektive të peshkimit, me qëllim sigurimin dhe përmirësimin e zhvillimit të qëndrueshëm në mjedisin ujor.</p> <p>5. Kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave për zonat e mbrojtura të peshkimit.</p> <p>6. Kopje të urdhrimit të ministrit në fuqi në ditën e shpalljes së tenderit dhe lidhjes së kontratës me subjektin “Alb Ligatina” sh.p.k në të cilin</p>		<p>1. Vendimin Nr. 24, datë 14.5.2020;</p> <p>2. Shkresën Nr. 3454/1 prot, datë 14.5.2020 “Dërgim për publikim”.</p> <p>2. Bashkëlidhur gjeni Udhëzimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Nr. 11, datë 10.9.2020 “Për procedurat e monitorimit të kontratave për ushtrimin e aktivitetit të peshkimit në ujërat e brendshme dhe akuakulturën tokësore dhe ujore”.</p> <p><u><a href="#">Informacion</a></u></p> <p>3. Nuk ka raporte të monitorimit për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara nga kontrata. Monitorimi i kontratës bëhet me planifikim.</p> <p>4. Në linkun: <a href="http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/alb163132.pdf">http://extwprlegs1.fao.org/docs/pdf/alb163132.pdf</a> mund të gjeni Rregulloren Nr. 1, datë 7.3.2014 “Për zbatimin e Ligjit Nr. 64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

		<p>përcaktohen zonat ku ndalohet peshkimi.</p> <p>7. Kopje të dokumentit “Politikat strukturore në peshkim” në fuqi në ditën e shpalljes së tenderit dhe lidhjes së kontratës me subjektin “Alb Ligatina” sh.p.k.</p> <p>8. Lajmërimin që i është bërë subjektit pronar X Y për përdorimin e pronës së saj.</p> <p>9. Bazën ligjore ku jeni mbështetur për të dhënë me kontratë të drejtën e shfrytëzimit të tokës private të znj. X Y.</p>		<p>5. Nuk ka vendim të Këshillit të Ministrave për zonat e mbrojtura të peshkimit.</p> <p>6. Nuk ka urdhër të ministrit për zonat ku ndalohet peshkimi.</p> <p>7. Nuk ka politika strukturore enkas për këtë zonë. Parimet e politikës strukturore përcaktohen në nenin 17 të Ligjit Nr. 64, datë Ligjit Nr. 64, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, ndërsa politikat e peshkimit përcaktohen në Strategjinë Kombëtare të Peshkimit, të cilën mund t’a gjeni në linkun: <a href="https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/Strategjia-e-peshkimit-VKM-701-e-2016-1.pdf">https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2019/04/Strategjia-e-peshkimit-VKM-701-e-2016-1.pdf</a> .</p> <p>8. MBZHR ka dhënë me kontratë të drejtën e zhvillimit të aktivitetit në sipërfaqe ujore dhe jo në tokë.</p>		
--	--	---	--	--	--	--

			<p>9. Nuk kemi dhënë për shfrytëzim tokë private. Objekti i kontratës (Nr. 3706 prot, datë 22.5.2020) është përacaktuar në nenin 1 të saj, sipas të cilit:</p> <p>“1. Kjo kontratë ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit të peshkimit artizanal me dajlan nga ana e subjektit juridik “Alb Ligatina” sh.p.k, në objektin ujqor: Zona Ligatinore Kallëngë-Godull, me indeks harte (bashkëlidhur) me koordinata:</p> <p style="text-align: center;">K-34-123-B-a; K-34-123-B-b; K-34-123-B-c; K-34-123-B-d;</p> <p>me sipërfaqe ujore që varion nga 10 – 57 ha gjatë vitit, Njësia Administrative Novoselë, Vlorë, i shpallur fitues nga ana e Ministrisë në konkurrimin publik të zhvilluar më datë 10.3.2020.</p> <p>2. MBZHR i njeh të drejtën e zhvillimit të aktivitetit të peshkimit artizanal me dajlan, subjektit juridik “Alb Ligatina” sh.p.k brenda të gjithë kuadrit ligjor që rregullon këtë aktivitet,</p>		
--	--	--	---	--	--



				në zonën e përcaktuar sipas pikës 1, të nenit 1”.		
41	19.7.2021	<p>1. A ka pas Ministria e Bujqësisë insiativa për subvencionet e fermerve Shqiptarë?</p> <p>2. Cili është mekanizmi për vënien në dispozicion dhe shpërndarjen e këtyre insiativave?</p> <p>3. Këto insiativa finaciare jepen direkt te fermeri apo ka mekanizma të tjera si p.sh., pikat e grumbullimit të produkteve të fermerëve?</p> <p>4. Për vitet 2018, 2019 dhe 2020 sa fermerë kanë përfituar nga këto insiativa dhe sa ka qenë shuma e përfituar dhe duke parë gjendjen aktuale nëse këto insiativa kanë qenë sukses apo dështim, a parashikon shteti ndryshimin e mekanizmave aktual?</p>	22.7.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Informacion</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>5. Për produkte të caktuar pse favorizohet importi duke qenë se tregu i brendshëm është i mbingopur dhe fermerët tanë detyrohen ti hedhin?</p> <p>6. Pse janë të pakta pikat e grumbullimit në zonën e Lushnjës dhe ato që janë e kanë kthyer tregun në monopol?</p>				
42	21.7.2021	<p>1. Sa është numri total i personave që kanë përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare Mbështetëse gjatë periudhës dhjetor 2019 – maj 2020?</p> <p>2. Sa është numri i të rinjve (15 – 29 vjeç) që kanë përfituar mbështetje financiare nga Skema Kombëtare Mbështetëse gjatë periudhës dhjetor 2019 – maj 2020?</p>	23.7.2021	<p>Institucioni kompetent për ndjekjen e procedurave për përfitimin e subvencioneve nga shteti për skemat mbështetëse është Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në adresën Info@azhbr.gov.al .</p>	Deleguar	0

43	26.7.2021	<p>1. Kërkohet informacion në mënyrë zyrtare në lidhje me NMP për SRPP (Njësia e Menaxhimit të Projektit për Sistemin e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) Elbasan.</p> <p>2. Çfarë kompanie ishte dhe kush e menaxhonte, çfarë marrëdhënie kishte me ASHK Elbasan (ish ZRPP) dhe a ishte X Y punonjës i kësaj kompanie ose i kontraktuar me kohë të pjesshme? Nëse po, çfarë viti ka punuar?</p>	2.8.2021	<p>1. Njësia e Menaxhimit të Projektit (NMP) për regjistrimin e pasurive të paluajtshme ka përfunduar veprimtarinë e saj në fund të vitit 2005. Në VKM Nr. 159, datë 21.3.2006 “Për mbylljen e Njesisë së Menaxhimit të Projektit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, pika 2, përcaktohej që: “Arkiva dhe të gjitha funksionet të cilat lidheshin me regjistrimin e pasurive të paluajtshme i janë transferuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” (sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës).</p> <p>2. Lidhur me kërkesën tuaj se kush e menaxhonte këtë njësi, sqarojmë se projekti kishte si donator USAID dhe PHARE, si dhe Qeverinë Shqiptare.</p> <p>3. Lidhur me kërkesën tuaj se a ishte X Y punonjës i kësaj</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
----	-----------	--	----------	---	-------------------------------	---

				kompanie, nga informacioni që morëm rezulton se X Y nuk ka qenë koordinator i NMP, por ka qenë topograf i kontraktuar me kontrata të pjesshme, për të bërë punime fushore (topografike) në terren. Lidhur me këtë, mund t'i drejtoheni Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan si një nga palët kontraktuese.		
44	9.8.2021	<p>1. Sa i plotëson kërkesat e fermerëve shqiptarë Skema Kombëtare për Bujqësinë e financuar nga buxheti i shtetit?</p> <p>2. Krahasuar me vitin paraardhës kjo skemë ka një rritje të buxhetit, sa është rritja dhe pse ndodhi ky ndryshim buxhetor për 2021?</p> <p>3. A mjafton kjo skemë për ta bërë konkurruese bujqësinë shqiptare qoftë edhe në rajon?</p>	9.8.2021	<p>Institucioni kompetent për ndjekjen e procedurave për përfitimin e subvencioneve nga shteti për skemat mbështetëse është Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural në adresën Info@azhbr.gov.al .</p>	Deleguar	0

		<p>4. Si renditet Shqipëria në krahasim me rajonin sa i përket financimit për fermerin nga buxheti i shtetit?</p> <p>5. Jeni në proces përfundimi sa i përket skemës dhe përfituesve. Sa janë fermerët që kualifikohen këtë vit dhe kush nga kategoritë është në numër më të lartë?</p>				
45	19.8.2021	<p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ofron asistencë teknike për fermerët?</p> <p>Si këshillohen fermerët, ju i drejtoni drejt kulturave bujqësore?</p> <p>Cili sektor merret me këshillimin e fermerëve? Çfarë kërkojnë ata?</p>	19.8.2021	<p>Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Kërkesa Nr 45</a></p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0
46	23.8.2021	<p>Sqarim për kapacitetin minimal për pajisjen me leje mjedisi për rritjen intensive të dosave.</p>	31.8.2021	<p>Dhënia e lejeve mjedisore nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për rritjen intensive të kafshëve është objekt i Ligjit Nr. 10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				<p>Bazuar në këtë ligj, për rritjen intensive të dosave leja e mjedisit është e detyrueshme për instalimet (stabilimentet) nga 100 krerë e lartë.</p> <p>Për mbarështrimin e derrave me peshë 30 kg e lartë leja mjedisore është e detyrueshme për instalimet (stabilimentet) me kapacitet nga 200 krerë e lartë.</p>		
47	1.9.2021	<p>1. Sa ka qenë vlera monetare e parashikuar për projektin “100 fshatrat”?</p> <p>2. Në sa fshatra është ndërhyrë në kuadër të këtij projekti?</p> <p>3. Sa ka qenë kohëzgjatja e këtij projekti?</p>	1.9.2021	<p>Me miratimin e Ligjit Nr. 99/2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019” zbatimi i investimeve të programit 100 fshatrat (Programit të Integruar të Zhvillimit Rural) i ka kaluar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar Fondit Shqiptar të Zhvillimit në adresën <a href="mailto:sdemko@albaniandf.org">sdemko@albaniandf.org</a>.</p>	Deleguar	0

	<p>4. Ju lutem na vendosni në dispozicion ndërhyrjet e bëra në secilin prej fshatrave dhe vlerën monetare që kanë kushtuar.</p> <p>5. Sa akse rrugore janë ndërtuar në kuadër të projektit “100 fshatrat” dhe sa ka kushtuar secili prej këtyre akseve?</p> <p>6. A ka fshatra të cilët janë përzgjedhur për të qenë pjesë e këtij programi, por që nuk është arritur të bëhet asnjë ndërhyrje?</p> <p>7. Cila ka qenë arsyeja që nuk është bërë e mundur të ndërhyej në këto fshatra (nëse ka)?</p> <p>8. A ka patur raste ku pengesë për ndërhyrjen në kuadër të</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>projektit “100 fshatrat” është bërë mungesa e dokumentave të pronësisë?</p> <p>9. Ju lutem na listoni të gjithë fshatrat të cilët kanë qenë të përzgjedhur për të qenë pjesë e projektit por që nuk kanë përfituar nga ky projekt dhe arsyet se pse.</p> <p>10. Ju lutem na vendosni në dispozicion projektet e parashikuara për t’u zhvilluar në kuadër të projektit “100 fshatrat”.</p>				
48	4.10.2021	<p>1. A është ministria në dijeni të përdorimit dhe tregtimit të pesticidit Chlorpyrifos-ethyl teksa në vendet e BE ky produkt është tërësisht i ndaluar? Cila është arsyeja?</p> <p>2. Po sa i përket Fenbuconazole? Pse ky</p>	4.10.2021	Bashkëlidhur informacioni <a href="#">Kthim përgjigje</a>	Përgjigja është dhënë e plotë	0



		<p>pesticid teksa është ndaluar përdorimi i mëtejshëm në BE, është akoma tek lista e PMB-ve të regjistruara për t'u importuar dhe tregtuar në Republikën e Shqipërisë / qershor 2021?</p> <p>3. A ka parë ministria mundësinë e largimit nga tregu të të gjithë PMB-ve me përmbajtje Chlorpyrifos, pasi ai është i ndaluar në BE, dhe në Shqipëri vazhdon dhe shitet, teksa mbetjet e tij janë problem si në prodhimet konvencionale si në ato organike?</p>				
49	8.10.2021	1. A ka vendosur institucioni juaj një set tarifash për marrjen e informacionit nëpërmjet kërkesës për informacion të parashikuar nga Ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas nenit 13 të tij?	8.10.2021	1. Bazuar në nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me Urdhrin Nr. 597, datë 30.11.2016 "Për tarifën e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar" ka përcaktuar tarifën e	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>2. A janë publike këto tarifa, nëse po, mund të vini në dispozicion link URL në të cilin janë publikuar?</p> <p>3. Nëse institucioni juaj ka një listë të tarifave për riprodhimin e informacionit publik, sipas nenit 13 të Ligjit Nr. 119/2014 "<i>Për të drejtën e informimit</i>", kërkoj të më vihet në dispozicion informacioni mbi këto tarifa për mënyrat/format e ndryshme të vënies në dispozicion të informacionit.</p> <p>4. Nëse institucioni juaj ka një udhëzim, urdhër apo vendim mbi tarifën e vendosjes në dispozicion të informacionit kërkesve të ndryshëm, kërkoj të më vihet në dispozicion relacioni shpjegues, metodologjia dhe</p>		<p>dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar.</p> <p>2. Tarifat e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar janë publikuar në linkun: <a href="https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/urdheri_i_ministrit_per_web_001.pdf">https://bujqesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/urdheri_i_ministrit_per_web_001.pdf</a>.</p> <p>3. Informacioni në rrugë elektronike jepet falas. Për dhënien e informacionit (dokumentacionit) mbi 10 (dhjetë) fletë, për formatin A4, tarifa është 5 (pesë) lekë për fletë. Për dhënien e informacionit me CD, tarifa është 60 (gjashtëdhjetë) lekë për CD.</p> <p>4. Urdhri Nr. 597, datë 30.11.2016 "<i>Për tarifën e dhënies së informacionit</i></p>		
--	--	--	--	--	--	--

		<p>baza ligjore zyrtare të cilat mbështesin vendimin në fjalë për përcaktimin e këtyre tarifave?</p>	<p><i>(dokumentacionit) të kërkuar" që ka përcaktuar tarifat e dhënies së informacionit (dokumentacionit) të kërkuar, është bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Për këtë urdhër nuk ka një relacion shpjegues sepse mënyra se si do të përcaktohet kostoja e riprodhimit të informacionit është e përcaktuar në nenin 13, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", sipas të cilit:</i></p> <p><i>"Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se sa kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare të njëjtit shërbim në treg."</i></p> <p>Nga sa më sipër, ka rezultuar se kostoja e printimit të 1 (një) flete A4 është 5 (pesë) lekë dhe</p>		
--	--	--	--	--	--

				kostoja e 1 (një) CD është 60 (gjashtëdhjetë) lekë.		
50	12.10.2021	<p>Duke marrë shkas nga ankesa në qytetin e Përmetit, kërkohet informacion:</p> <p>A funksionon kjo thertore apo jo?</p> <p>Nëse po, sa është numri i therjeve në 3 muajt e fundit?</p> <p>Në qoftë se jo, arsyen pse nuk funksionon kjo thertore?</p> <p>Gjithashtu, kërkohet informacion për numrin e thertoreve të licencuara në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, vendet ku ato ndodhen, numrin e veterinerëve të punësuar në çdo thertore, si dhe numrin e</p>	18.10.2021	<p>Në pikën 12, Kreu III të VKM-së Nr. 708, datë 9.9.2020 "<i>Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit</i>", përcaktohet se:</p> <p><i>"Drejtoritë rajonale (të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit) kanë detyrat e mëposhtme:</i></p> <p><i>a) kryejnë kontrollin zyrtar të ushqimeve, të ushqimeve për kafshë, të inpueteve bujqësore, të veprimtarive prodhuese të duhan-cigareve dhe kontrollin zyrtar në pikën e inspektimit kufitar të shëndetit të kafshëve, produkteve mjekësore veterinarë dhe produktet e mbrojtjes së bimëve;"</i></p>	Deleguar	0

		therjeve për 3 muajt e fundit në çdo thertore?		<p><i>b) kryejnë kontrollet paraprake për përmbushjen e kërkesave tekniko - teknologjike, higjeno - sanitare, fitosanitare dhe veterinare, verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin dhe licencimin e operatorëve të biznesit të ushqimit, ushqimit për kafshë dhe produktet e mbrojtjes së bimëve dhe inputeve bujqësore..."</i></p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkesa i është dërguar Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në adresën <a href="mailto:Klaudio.Gica@aku.gov.al">Klaudio.Gica@aku.gov.al</a>.</p>		
51	3.11.2021	Informacion lidhur me sasinë e qumështit që prodhohet në vendin tonë, si dhe sasinë e qumështit me origjinë nga jashtë, që po ashtu tregtohet në vend.	8.11.2021	Në bazë të Ligjit Nr. 17/2018, datë 5.4.2018 "Për statistikën zyrtare", i ndryshuar, INSTAT është i vetmi autoritet zyrtar përgjegjës për publikim dhe shpërndarjen e informacioneve statistikore zyrtare në Shqipëri.	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				<p>Të dhënat e kërkuara për prodhimin vendas të qumështit janë të botuara dhe mund të aksesohen në databazën statistikore të INSTAT për periudha kohore në temën “Blegtori”, në linkun e mëposhtëm:</p> <p><a href="http://databaza.instat.gov.al/px/web/sq/DST/START_BL/NewBL0012/?rxid=9715ee35-20b1-432a-90e5-94587c8fc65b">http://databaza.instat.gov.al/px/web/sq/DST/START_BL/NewBL0012/?rxid=9715ee35-20b1-432a-90e5-94587c8fc65b</a></p>		
				<p>Të dhënat e kërkuara për sasinë e qumështit me origjinë nga jashtë/të importuar, janë të botuara dhe mund të aksesohen në databazën statistikore të INSTAT në temën “Tregtia e jashtme”, në linkun e mëposhtëm:</p> <p><a href="http://databaza.instat.gov.al/px/web/sq/DST/START_FT_FTY/NewFTY001/?rxid=5b050f4a-4cc1-4fa7-ab77-d2f007632543">http://databaza.instat.gov.al/px/web/sq/DST/START_FT_FTY/NewFTY001/?rxid=5b050f4a-4cc1-4fa7-ab77-d2f007632543</a></p>		

52	6.11.2021	Shkresa që MBZHR i ka përcjellë Agjencisë së Basenit Ujor Mat, në përgjigje të shkresës Nr. 80 prot., datë 8.5.2017 “Dërgim të dokumentacionit të mbledhjes së K.B.U. Mat datë 27.4.2017” dhe shkresën tjetër që i referohet sërish mbledhjes së Këshillit të Basenit Ujor Mat, për mbledhjen e datës 27.2.2017.	24.11.2021 1	Nga kërkimi në Arkivën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural rezulton se nuk është protokolluar shkresë në përgjigje të dokumentacionit që ka dërguar Agjencia e Basenit Ujor Mat për mbledhjet e Këshillit të Basenit Ujor Mat. Shkresa që ka dërguar Agjencia e Basenit Ujor Mat është një shkresë informuese dhe në të nuk kërkohet përgjigje.	Përgjigja është dhënë e plotë	0
53	8.11.2021	<p>Informacion mbi peshkimin në Shqipëri për periudhën 2016 – nëntor 2021.</p> <p>1. Të dhënat statistikore mbi sasinë e peshkut të zënë në Shqipëri në ujëra të ëmbla (liqenet Shkodër, Prespë, Ohër, Fierzë, etj.) dhe ujëra të kripura, sipas viteve.</p> <p>2. Të dhëna mbi peshkimin e paligjshëm në det dhe në liqene.</p>	22.11.2021 1	<p>Bashkëlidhur informacioni</p> <p><a href="#">Kthim përgjigje</a></p> <p><a href="#">Raportimet për përgjigjen e kërkesës</a></p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		<p>3. Raportet vjetore të ministrisë dhe Drejtorisë së Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës, për vitet si më sipër.</p> <p>4. Raporte apo dokumente të tjera të mbajtura në lidhje me specie në rrezik dhe peshkimin e tyre.</p>				
54	10.11.2021	<p>1. A është hartuar një plan në lidhje me vendosjen e paneleve diellore në stane? Nëse po, ju lutem na e vini në dispozicion.</p> <p>2. Kur është menduar që të realizohet vendosja e paneleve diellore në stane?</p> <p>3. A jeni konsultuar me grupet e interesit për këtë çështje?</p> <p>4. A jeni konsultuar me Ministrinë e Infrastrukturës</p>	24.11.2021	<p>Në skemat e financimit përmes skemave kombëtare 2018, u parashikua "Mbështetje për përmirësimin e kushteve në stane për bagëtitë e imta (rikonstruksion dhe pajisje me panele fotovoltaike), në 80% të vlerës totale të faturave tatimore, por jo më shumë se 200 000 (dyqind mijë) lekë".</p> <p>Lidhur me skemën financiare për vitin 2022 është ngritur grupi</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0



		<p>dhe Energjisë në lidhje me këtë plan?</p> <p>5. A ka pasur fonde të caktuara për blerjen e paneleve diellore? Nëse po, në çfarë fushash?</p>		<p>i punës, i cili do të bëjë propozimet konkrete.</p>		
55	16.11.2021	<p>Marrë shkas nga një postim që ka bërë Kryeministri z. Edi Rama në facebook, ku është publikuar një shifër prej 7.1 miliardë lekë, është kërkuar informacion nëse kjo shifër përfaqëson buxhetin total të ministrisë, apo ndihmën direkte për fermerët.</p> <p>Gjithashtu, kërkohet informacion se me cilën shifër të vitit të kaluar krahasohet ky buxhet.</p>	23.11.2021	<p>Shifra 7.1 miliardë lekë, përfaqëson shpenzimet e programit buxhetor “Zhvillimi Rural”. Buxheti total i ministrisë është 12.7 miliardë lekë.</p> <p>Ndihma direkte për fermerët, pra, skema kombëtare dhe nafta pa taksë për fermerët është 3.2 miliardë lekë, 3.5 miliardë lekë investime në Zhvillim Rural dhe 0.4 miliardë lekë janë shërbime mbështetëse për funksionim institucioni.</p> <p>Kjo shifër, pra 42 % më shumë, është krahasim i buxhetit të programit për zhvillim rural nga 5.9 miliardë lekë në vitin 2021 në 7.1 miliardë lekë në vitin 2022.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

56	16.11.2021	<p>1. Sa është buxheti për programin e 100 Fshatrave Turistikë për vitet 2018, 2019, 2020 dhe buxheti i përgjithshëm i shtetit për këtë program?</p> <p>2. Sa fshatra turistike janë mbështetur me fonde dhe cilët janë ato fshatra, si dhe sa është shuma e fondit për secilin fshat që ka marrë mbështjete ?</p> <p>3. Të dhëna se sa fshatra turistike kanë fituar dhe sa fshatra nuk kanë fituar.</p>	23.11.2021 1	<p>Me miratimin e Ligjit Nr. 99/2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019” zbatimi i investimeve të programit 100 fshatrat (Programit të Integruar të Zhvillimit Rural) i ka kaluar Fondit Shqiptar të Zhvillimit.</p> <p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kërkesa i është dërguar Fondit Shqiptar të Zhvillimit në adresën <a href="mailto:sdemko@albaniandf.org">sdemko@albaniandf.org</a>.</p>	Deleguar	0
57	16.11.2021	Informacion më i detajuar se si do të mbështeten fermerët, pas heqjes së TVSH-së së rimbursueshme.	23.11.2021 1	<p>Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është në fazën e hartimit të masave financiare të mbështetjes për vitin 2022.</p> <p>Krijimi i kushteve lehtësuese për fermerët do të jetë fokusi i</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				hartimit të skemës. Procesi pritet të përfundojë brenda vitit 2021.		
58	19.11.2021	<p>1. Cilat janë kriteret ligjore dhe procedurat që ndiqen për të kryer sigurime të ndryshme sipas nevojave të institucionit tuaj?</p> <p>2. Me cilët operatorë shqiptarë janë realizuar kontratat e sigurimeve të institucionit tuaj gjatë viteve 2017, 2018, 2019, 2020 dhe 2021?</p> <p>3. Cilët lloje sigurimi keni realizuar?</p> <p>4. Një kopje të kontratave për periudhën e vitit 2017.</p>	10.1.2022	<p>1. Rregullat për procedurat e prokurimit për lidhjen e kontratave të sigurimit janë të përcaktuara në Ligjin Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.</p> <p>2. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka lidhur kontratë sigurimi me këta sigurues: në vitin 2017 me Albsig, në vitin 2018 me Euro-Sig, në vitin 2019 me Albsig, në vitin 2020 dhe 2021 me Insig.</p> <p>3. Kontratat e sigurimit janë lidhur për sigurimin e aseteve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nga rreziqet: zjarr, tërmet dhe përmytje.</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				4. Bashkëlidhur, kontrata e sigurimit, Nr. serial: 59071907, datë 7.12.2017.  <a href="#">POLICE SIGURIMI</a>		
59	23.11.2021	<p>Gjatë një emisioni në një televizion, drejtoresha e AKVMB, është shprehur se gjatë këtij viti, është konstatuar vetëm një rast me mbetje antibiotike.</p> <p>Sa më sipër, kërkojmë informacion për çfarë produkti bëhet fjalë, cila është data që mostra është çuar për analiza zyrtare, cila është data që ka dal analiza zyrtare, si dhe çfarë masash janë marrë kur është marrë analiza dhe më vonë pasi ka dalë rezultati?</p> <p>Gjithashtu, kërkojmë informacion sa është nr. i mostrave që zyrtarisht kanë rezultuar pozitive në mbetje</p>	26.11.2021	<p>Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", kërkesa i është dërguar Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve në adresën <a href="mailto:danjel.sovjani@akymb.gov.al">danjel.sovjani@akymb.gov.al</a>.</p>	Deleguar	0

		me antibiotikë deri më datë 8.11.2021?				
60	19.11.2021	Kopje të marrëveshjes që është nënshkruar me Qeverinë Britanike lidhur me emigrantët.	26.11.2021	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nuk ka marrëveshje të lidhur me Qeverinë Britanike. Kërkesa përkon me fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme.  Bazuar në nenin 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 119/2014 " <i>Për të drejtën e informimit</i> ", kërkesa i është dërguar Ministrisë së Brendshme në adresën <a href="mailto:Ardian.Bita@mb.gov.al">Ardian.Bita@mb.gov.al</a> .	Deleguar	0
61	6.12.2021	1. Si do të funksionojë akademia për barinjte?  2. Çfarë mbështetje do të ofroni për barinjte?  3. Si do të bëhet subvencionimi për ta?	6.12.2021	Në nenin 2, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 119/2014 " <i>Për të drejtën e informimit</i> " përcaktohet se:  <i>"Informacion publik" është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.</i>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

		4. Në çfarë afati është parashikuar që të realizohet kjo?		<p>Shkolla e barinjve është pjesë e një cikli trajnimesh të dedikuara për blegtorët, peshkatarët, fermerët dhe bletarët. MBZHR është aktualisht në fazë konsultimesh me aktorë rajonal dhe ndërkombëtar, shtetëror dhe privat, për të adoptuar formatin me impaktin më të ndjeshëm, sipas praktikave të njohura më të suksesshme (Spanjë, Francë).</p> <p>Grupet e punës janë ngritur dhe përgjigjet për pikat 2, 3, dhe 4 janë në varësi të kohës së përfundimit të fazave të konsultimit dhe do të informoheni sapo të jenë gati.</p>		
62	7.12.2021	Pse eksportet shqiptare të peshkut janë më të larta në Iran?	16.12.2021 1	<p>Në lidhje me pyetjen tuaj se pse eksportet shqiptare të peshkut janë më të larta në Iran, është e rëndësishme të specifikohet perioda së cilës i referoheni.</p> <p>Për sa i përket informacionit mbi produktet e peshkut të</p>	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				<p>eksportuara, na lejoni të theksojmë se ky informacion del nga disa tregues ndër të cilët tre kryesorët janë: peshku i papërpunuar i eksportuar, peshku i përpunuar i eksportuar, karkaleci i përpunuar i eksportuar. Nëpërmjet këtyre të dhënave është e mundur të arrihet në konkluzionin se në cilin shtet, për një periudhë të caktuar, rezultojnë më shumë eksporte nga Shqipëria.</p> <p>Nëse do ju nevojiten të dhëna mbi vlerën dhe sasinë e produkteve të eksportuara apo vendet e destinacionit, për një periudhë të caktuar, mund ti përcjellim pas një kërkesë për informacion nga ana juaj.</p>		
63	16.12.2021	Ndërhyrjet në argjinaturat mbrojtëse të lumit Vjosa, në fshatin Çerven dhe Fitore.	22.12.2021 1	Në lidhje me kërkesën për informacion mbi ndërhyrjet në argjinaturat mbrojtëse të lumit Vjosa, në fshatin Çerven dhe Fitore, nga informacioni i marrë	Përgjigja është dhënë e plotë	0

				<p>nga Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier, rezulton se:</p> <p>Në argjinaturën e djathtë të lumit Vjosa, që prek fshatin Çerven, është ndërhyrë nga Bashkia Fier për mbingritjen e kësaj argjinate nga segmenti "Kolektori i Klosës" deri në Ferras (ura e rrugës së vjetër Fier - Vlorë).</p> <p>Në argjinaturën e majtë të lumit Vjosa, ngjitur me shtratin e majtë të lumit Vjosa, në Mifol, që prek fshatin Fitore, referuar Kryetarit të Njesisë Administrative Novoselë, Bashkia Vlorë, ndërhyrja është bërë nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.</p>		
64	2.12.2021	Informacion për mënyrën dhe kriteret për kryerjen e veprimtarisë së rritjes së kafshëve helmuese (akrepa).	13.12.2021	Legjislacioni veterinar në fuqi nuk parashikon mënyrën dhe kriteret për kryerjen e veprimtarisë së rritjes së kafshëve helmuese (akrepa).	Përgjigja është dhënë e plotë	0



